



Në bazë të Marrëveshjes për bashkëpunim në mes Agjencisë për Punësime të RMV-së (APRMV), Programit për Zhvillim të Kombeve të Bashkuara (UNDP) dhe Qytetit të Shkupit, Planit operativ për programet dhe masat aktive për punësime dhe shërbime të tregut të punës për vitin 2020, të miratuar nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut, Programit për punë të dobishme komunale, të financuar nga Buxheti i Agjencisë për Punësime të RMV-së, më datën 20.08.2020 shpallet:

**THIRRJE PUBLIKE**  
**për personat e evidentuar si të papunësuar për përfshirje në**  
**Programin për punë të dobishme komunale**

Ftohen të gjithë personat e evidentuar si të papunësuar, të cilët shprehin interesim që të përfshihen në Programin për punë të dobishme komunale, projekti “Mbështetje e përfshirjes në procesin arsimor - avancimi i të drejtave dhe mundësive të kategorive të qytetarëve në nevojë në Qytetin e Shkupit”, për angazhim në punë për 20 (njëzet) orë në javë për periudhën prej 9 (nëntë) muajsh me qëllim përvetësimin e aftësive dhe përfshirjen e tyre graduale në tregun e punës, të paraqiten në Agjencinë për Punësime të Republikës së Maqedonisë së Veriut – Qendra për Punësime e Qytetit të Shkupit.

Personat e evidentuar si të papunësuar, të cilët do të përfshihen në Programin “Punë e dobishme komunale”, do të angazhohen për 20 (njëzet) orë pune në javë.

Gjatë periudhës kur personat janë të angazhuar në punë përmes programit “Punë e dobishme komunale”, nuk e humbasin statusin e personit të papunësuar dhe të njëjtët janë të detyruar që të paraqiten rregullisht në Agjencinë për Punësime të Republikës së Maqedonisë së Veriut - Qendra për Punësime e Qytetit të Shkupit me qëllim respektimin e obligimeve në pajtim me Ligjin. Personave të papunësuar - përfitues të ndihmës sociale gjatë kohës së angazhimit të tyre në punë do t'u mbetet aktive e drejta e shfrytëzimit të ndihmës sociale.

Të drejtë për pjesëmarrje në Programin “Punë e dobishme komunale”, kanë të gjithë personat e papunësuar, ku përparësi do të kenë personat të cilët aplikojnë për herë të parë për pjesëmarrje në këtë Program.

Për kandidatët të cilët do të zgjidhen dhe përfshihen në Programin “Punë e dobishme komunale”, parashikohet kompensim në të holla në vlerë prej 9.000 denarë në muaj, duke llogaritur tatimin mbi të ardhurat personale dhe sigurimin për invaliditet dhe lëndime trupore të shkaktuar nga lëndime në punë dhe sëmundje profesionale.

Personat e evidentuar si të papunësuar, të cilët do të aplikojnë për pjesëmarrje në Programin për punë të dobishme komunale, duhet t'i përkasin njërit prej këtyre grupeve të synuara të personave të papunësuar:

- persona të papunësuar një periudhë më të gjatë kohore (mbi 12 muaj në evidencë, me përparësi për personat e papunësuar mbi 5 vite)
- të rinj deri në moshën 29 vjeçare
- persona më të vjetër se 50 vjet
- persona përfitues të ndihmës sociale ose përfitues të kompensimit në të holla në bazë të papunësisë
- persona që kanë qenë përfitues të Programit për kompensim në të holla të kushtëzuar për arsimin e mesëm
- persona të cilët kanë pasur statusin e fëmijëve pa prindër dhe pa përkujdesje prindërore
- viktima të dhunës familjare
- gra që i përkasin bashkësisë etnike rome
- prindër të vetëm
- prindër të fëmijëve me aftësi të kufizuara
- prindër të 3 apo më shumë fëmijëve

Pozitat e punës të përfshira me këtë thirrje publike, kanë të bëjnë me angazhimin e:

- asistent arsimor

Personat e papunësuar që janë të interesuar, Fletëparaqitjet për pjesëmarrje në Programin “Punë e dobishme komunale”, mund t’i dorëzojnë në Agjencinë për Punësime të Republikës së Maqedonisë së Veriut - Qendra për Punësime e Qytetit të Shkupit, në periudhën nga 20.08.2020 deri më 26.08.2020, nga ora 08:00 deri në orën 14:00.

Kushtet më konkrete, të drejtat dhe obligimet do të rregullohen me lidhjen e Kontratës në mes Qytetit të Shkupit dhe kandidatëve të përzgjedhur.

Informacione më të hollësishme në lidhje me Programin “Punë e dobishme komunale”, mund të merren në Sektorin për Arsim pranë Qytetit të Shkupit, te personi Sulltana Çuleva, Koordinator komunal për Programin “Punë e dobishme komunale”, Agjencia për Punësime e Republikës së Maqedonisë së Veriut - Qendra për Punësime e qytetit të Shkupit, te personi Nikolla Gjurovski, Qendra Ndërkomunale për Punë Sociale - Shkup, te personi Aneta Trajkovska.